



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 16, dt. 31.10.2022

MBI DISA NDRYSHIME NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2022

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2022, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 14 datë 22.12.2021”Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2022”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshime në buxhetin e Këshillit të Qarkut dhe rialokimin e fondeve të investimeve të paperdorura nga procedura e prokurimit si më poshtë:
 - a. Pakësimi fondi
00/04520/01/231 7150080 lekë (Rehabilitimi i rrugës të fshatit Cetë, Bashkia Devoll)
 - b. Shtese fondi
00/01110/01/604 7150080 lekë (Aktiviteti me Bashkinë Pogradec për Projektin e pastrimit të bregut të liqenit)
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ana VERUSHI

Kryetari i Këshillit të Qarkut





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI I QARKUT KORÇË

**RELACION
MBI DISA NDRYSHIME NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT
PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936 dt, 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2022 si dhe të Vendimit të Keshillit të Qarkut nr. 14 datë 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2022” ju paraqesim për miratim disa ndryshime në Buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2022.

Në mbështetje të kërkesave të Bashkive të Qarkut për financime, propozojmë disa ndryshime në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2022 brenda vlerave të miratuara. Qarku Korçë ka realizuar një marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Pogradec në kuadër të së cilës, Këshilli i Qarkut do të mbështesë financiarisht Bashkinë Pogradec për Projektin e pastrimit të bregut të liqenit. Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje propozojmë të bëhet ndryshimi në Buxhet për rialokimin e fondeve të investimeve të mbetura të papërdorura nga procedura e prokurimit si më poshtë:

- a. Pakësimi i fondi
00/04526/01/231 7150080 lekë (Rehabilitimi i rrugës të fshatit Cetë, Bashkia Devoll)

- b. Shtese e fondi
00/01110/01/604 7150080 lekë (Aktiviteti me Bashkinë Pogradec për Projektin e pastrimit të bregut të liqenit)

Korçë, me 28.10.2022

Oljona Beqiraj
Përgjegjëse Finance